



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 29

Datë: 18. 06. 2020. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 28/2020 i KQZ-së,
3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:
 - **Këshilli për Personel:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Rekrutimit për vitin 2020:
4. Të ndryshme.

-
1. **Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve. A ka dikush vërejtje, propozime...? Jo, kush është për këtë rend dite ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan në mënyrë unanime rendin e ditës.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 28/2020 i KQZ-së

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalit nr. 27/2020 me vërejtje nga z. Alim Rama, i cili kërkoi që të specifikohen pikë për pikë diskutimet. Ai, pati vërejtje rreth citimit të temës që është diskutuar në mbledhjen e kaluar. Në anën tjetër, Arianit Elshani kërkoi që në procesverbale të përfshihen emrat e anëtarëve që votojnë, për dhe kundër vendimeve që merren në mbledhje.

Rreth asaj se, a duhet që procesverbalet të pasqyrohen detajisht (100%) sipas stenogramit apo, procesverbalet të përkufizohen sipas një rregulle që nuk është e shkruar, por që dikton pasqyrimin e mbledhjeve mbi konditat e diskutimeve në masën e duhur – përmbajtjesore, shprehën mendimin e tyre: Valdete Daka, Čemailj Kurtiši, Eshref Vishi, Alim Rama, Sami Hamiti dhe Arianit Elshani.

2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Personel:

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Rekrutimit për vitin 2020

Nenad Rikallo: Këshilli për personel, është takuar sot në përbërje të plotë. Gjatë takimit, kemi shqyrtuar e Planit të Rekrutimit për vitin 2020 të përgatitur nga Sekretariati, dhe të sjellë në këshill për shqyrtim. Nga ky plan, shihet se ka vende të zbrazëta të cilat, pa humbur kohë duhet të plotësohen. Krye shefi, ka thënë se ka vende me prioritet që duhet të plotësohen, dhe se janë dy vende që janë zvogëluar: nga 88, në 86 vende. Në sekretariat, mendohet se ka vende të punës që duhet të plotësohen me urgjencë, dhe ka vende të punës që nuk janë me urgjencë. Në takimin e këshillit, është diskutuar edhe për atë që procesi të monitorohet, pra është diskutuar edhe për modalitetet se si KQZ mund ta monitoroj këtë proces.

Gjithashtu, është diskutuar edhe postin e zëvendësin të Krye shefit, i cili është në proces të një ankese ! Jemi dakorduar që, t'i drejtohem komisionit për relevant për ankesa, cili, shpeshojmë që do t'na japë udhëzime lidhur me këtë vend pune. Gjatë mbledhjes, kemi ardhur në përfundim se kjo çështje e zëvendësi të Krye shefit, është

tejet urgjent, si dhe zgjedhja e kryesuesit të KKZ-së në Istog. Siç dihet, këtu konkursi është anuluar!

Edhe në ZRPP, ndonëse qe shumë vite vendet e punës janë të zbrazëta, ato duhet të plotësohen, si dhe të bëhet përzgjedhja e zyrtarit të Listës Votuese...

Ndërsa që do të jemi në bisedime me Qeverinë për rikthimin e dy vendeve që na janë marrë, të përgatite shpallja e konkursit për zgjedhjen e Krye shefit, dhe të zyrtarit për Fondin e Partive Politike.

Mendoj që, dokumentin të cilin këshilli e ka miratuar unanimisht, do ta diskutojmë edhe këtu në këtë mbledhje.

Valdete Daka: Për një kohë të gjatë, nuk i kemi plotësuar pozitat vakante që i kemi pas. Nuk dua tash t'i diskutoj shkaqet dhe arsyet, sepse i kemi diskutuar kushedi sa herë. Prandaj, ne e kemi obligim ligjor që ti plotësojmë pozitat që i kemi të zbrazëta...

Shumica e vendeve, janë të stafit civil, ndonëse është edhe pozita e Krye shefit dhe e Zëvendës kryeshefit...

Eshref Vishi: Pothuajse të gjitha çështjet që janë diskutuar në personel, u diskutuan nga kryesuesi i këshillit ! Është një plan që është i vonuar, dhe ka qenë dashur që të miratohet më herët...Mirëpo, duke i marr parasysht rrethanat nëpër të cilat kemi kaluar, nuk është vonë as tani. E falënderoj edhe Sekretariatit për kurajon dhe mundësinë e përpilimit të këtij plani, dhe ne na është dhënë mundësia që ta elaborojmë në detaje këtë plan, problematikat të cilat i kemi ngritë...Ajo që kemi kërkuar në mbledhjen e këshillit, është që Sekretariati të përmbushë anën ligjore dhe procedurale të planit, përpara se të ndërmerre veprime rekrutimi, dhe të kujdeset që të siguroj se janë përmbushë kushtet ligjore dhe ankimimet që janë në proces, dhe të mos kemi problematika në proces...

Valdete Daka: Ndoshta, kishte qenë mirë që të fillojmë t'i shqyrtojmë pozitat, dhe të diskutojmë për secilën veç e veç...! Si pozita ma e lartë, do kishim filluar me postin e Krye shefit, që të njëjtit i skadon mndati prej 6 muajve, dhe e kemi obligim ligjorë ta shpallim konkursin... Kemi pasur raste kur, kemi mbajtur pozita jashtëligjishëm, dhe kemi marrë vërejtje nga auditori...Nuk kemi nevojë që, t'i përsërisim...

Ta diskutojmë, fillimisht çështjen e monitorimit, sidomos për disa pozita të larta, siç është kjo e krye shefit...të diskutojmë...

Sami Kurteshi: E dëgjuam paraqitjen e kryesuesit të këshillit që ishte në rregull, por unë po e ngris çështjen e monitorimit. Kam shtruar çështjen, dhe kam thënë që procesi të monitorohet nga KQZ, dhe nuk kam kërkuar që të vij dikush nga jashtë...Të shihet baza ligjore, të shihet se në cilat vende është e mundur, dhe ku jo...Është edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, por unë kam hapur vetëm çështjen e monitorimit nga KQZ...

Arianit Elshani: Për mua, ka qenë ë çuditshme edhe hapja e kësaj teme në personel, pra kërkesa për monitorim nga anëtarët e KQZ-së. Për mua, kjo kërkesë paraqet ndërhyrje direkte politike në proces të rekrutimit, domethënë të punësimit, pra brenda KQZ kur, edhe e dimë që ky institucion duhet të qëndroj i pavarur dhe, i pandikuar politikisht nga partitë politike...

Secili nga ne si anëtar të KQZ që jemi këtu, tha ndër të tjera z. Elshani, e di që kemi ardhur nga partitë politike dhe se monitorimi nga ne, paraqet ndërhyrje, dhe unë jam kundër, decidivisht kundër...! Pra, ne nuk duhet të përfshihemi në proces të rekrutimit të stafit...

Sami Kurteshi: Duhet ta sqaroj: diçka tjetër është përfshirja në rekrutim, që domethënë marrja pjesë në vendim. Janë dy gjëra të ndryshme: me vëzhgua diçka, dhe vendimmarrja...! Monitorimi, vëzhgimi në asnjë rast nuk nënkupton ndërhyrje në proces qoftë me fjalë, qofte me vendim, qoftë në çfarëdo natyre...A ka bazë ligjore, apo s'ka bazë ligjore..! Unë e di që, nuk është e ndaluar ! Prandaj, Sekretariati e shikon nëse ka paqartësi ligjore, i drejtohet edhe KPM-së: në cilat raste lejohet monitorimi, e në cilat raste nuk lejohet...

Arianit Elshani: Kjo, i bie sikur një ministër apo një deputet, të përzihet në një proces të rekrutimit...

Sami Hamiti: Është mirë të diskutojmë ! I kemi dy nivele: në bazë të ligjit për zyrtar të lartë, dhe për shërbyes civil. Do të shkojmë me ligjin e vjetër, sepse ligji i ri ende s'është funksional...

Ligji për shërbyesit civil, përcakton qartë kriteret e rekrutimit. Pra, nuk ka interferim, nuk duhet të ketë interferim, kështu që duhet të vazhdoen procedurat sipas ligjit të shërbyesve civil...

Valdete Daka: Na e kemi një ligj, dhe le të vazhdohet sipas tij...kot pra bisedojmë...! Po dalim nga tema në temë...Ta përfundojmë së pari çështjen e kryeshefit, dhe pastaj të vazhdojmë me pozitat e tjera...

Në këtë temë, si për postin e zëvendës kryeshefit dhe si për postin e krye shefit, diskutuan më tej: Valdete Daka, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Nenad Rikallo dhe Ibrahim Selmanaj. Lidhur me problemet që lidhen me postin e zëvendës krye shefit, znj. Valdete Daka sqaroi se, ajo pozitë ka pasur konkurs, mirëpo është ankimuar dhe, ka mbetur pezull. Ndërsa, për postin e kryeshefit, tha znj. Daka, kemi pasur përfundimin e një kontrate, dhe pakënaqësinë e ish krye shefit për mos vazhdimin e kontratës. Pra, ka dallime në këto dy pozita...

Alim Rama: Propozoj që në parim, në pako t'i qesim në votim pozitat dhe të mos diskutojmë më tej... Të gjitha pozitat që janë të lira të shpallen dhe të mos diskutojmë kështu pa nevojë...!

Valdete Daka: Këtu, më duket janë edhe dy pozita që nuk i kemi, dhe se ato s'kan mbulesë buxhetore...Le të na shpjegoj më mirë Ylli...

Yll Buleshkaj: Kemi pasur diskutim, dhe në dokumenti që keni para jush janë të gjitha pozitat që kanë qenë vitin e kaluar të aprovuara. Dy nga to, këtë vit MEF nuk i ka parovuar, ndërsa për prioritetet e pozitave kemi vendosur ne... Ne, kemi buxhet edhe për këto dy pozita, dhe mund t'i mbulojmë 88 pozita...mirëpo, ende s'kemi konfirmim nga MEF që të na lejohen këto pozita...

Z. Buleshkaj, më tej shpjegoi se, cilat pozita janë konsideruar me prioritet. Pra, materiali është i gatshëm, dhe ne mund të fillojmë apo jemi të gatshëm që ti nisim menjëherë procedurat teknike, pastaj edhe t'i bëjmë shpalljet...

Valdete Daka: Për krye shef, të përcaktohem dhe të merret iniciativa për shpallje... Megjithatë, ta aprovojmë ne planin siç, propozoi Eshrefi dhe pastaj, e të vazhdohet me procedura...

Valdete Daka: A ta aprovojmë këtë plan. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, në parim miratuan planin e Rekrutimit për vitin 2020 me vota unanime.

Znj. Daka tha pas miratimit se, tani Sekretariati duhet të filloj procedurat për shpalljen e vendeve të lira. Ndërkaq, tha ajo, pozitën nr. 6 dhe 7, nuk mund ta shpallim, por as edhe pozitën e zëvendës krye shefit sepse, është në procedurë...

Arianit Elshani: Meqenëse u miratua plani, sa di unë, për shpalljen e postit të krye shefit, duhet vendim me marrë, pra duhet vendim i veçantë...Pra, duhet një vendim i veçantë...

Valdete Daka: Po, atëherë kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, më mënyrë unanime morën vendim për shpalljen e konkursit për pozitën e Kryeshefit të SKQZ-së

Valdete Daka: Sa i përkit postit të zëvendës krye shefit, ne mund ta kërkojmë një shpjegim ligjorë, Sekretariati t'i drejtohet KPM-së... Dy pozitat për zyrtarë komunalë janë në procedurë, ndërsa e kemi 1 pozitë në ZRPP (zyrtar i Lartë për Parti Politike) dhe, 1 - zyrtar i Lartë i Listës Votuese. Pra, këto dy vende të shpallen...

Rreth procedurave, mbarëvajtjes së procedurave të konkursit, diskutoi Alim Rama, i cili, kërkoi që, të ketë një komision prej Sekretariatit që mbikëqyrë panelet rekrutuese, pra ti mbajë përgjegjës ata përgjatë procedurave të rekrutimit... Po ashtu, z. Rama, iu khye edhe njëherë temës së monitorimit...

Vadete Daka: Këtë detyrë, e ka krye shefi...Ne, i kemi të ndara detyrat. Nuk është detyra e jonë kjo, procedurat e shpalljes dhe të rekrutimit...

Të ndryshme !

